



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Duke u bazuar në nenin 62, paragrafi 62.3, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), në dispozitat e Rregullores MF-Nr. 04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të Organizatave Joqeveritare, në nenin 27 të Rregullores Sh.02.Nr.31251, të datës 29.09.2023, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Sh.01.Nr.8620, të datës 14.04.2025, si dhe në nenin 75, paragrafi 75.1 dhe nenin 82 të Statutit Sh.01.Nr.20203, të datës 21.06.2023, të Komunës së Kamenicës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, duke u bazuar në dispozitat e sipërpërmendura, shpall:

THIRRJE PUBLIKE

Për subvencionimin e aktiviteteve teatrale në kuadër të "Summerfest 2026"

Në kuadër të aktiviteteve të **Kamenica Summer Fest**, i cili promovon artin, kulturën, trashëgiminë dhe identitetin lokal përmes aktiviteteve të ndryshme kulturore e sportive kjo thirrje ka për qëllim:

- Mbështetjen financiare të projekteve dhe aktiviteteve kulturore, artistike dhe teatrale, duke synuar gjithëpërfshirjen e fëmijëve dhe të rriturve në aktivitete dhe shfaqje teatrale.
- Inkurajimi i të rinjve dhe komunitetit për t'u marrë me aktivitete kulturore artistike dhe teatrale.
- Tërheqja e vizitorëve vendas dhe të huaj që janë të apasionuar pas artit, kulturës dhe pas shfaqjeve teatrale.
- Promovimi i vlerave kulturore, artistike dhe edukative që ndikon në mirëqënien e publikut.
- Pasurimin dhe promovimin e kulturës, duke ofruar njëkohësisht aktivitete kulturore dhe artistike për të rritur dhe fëmijë.

LOTI 1: Realizimi dhe menaxhimi i aktiviteteve të shfaqjes teatrale për fëmijë

- **Përshkrimi i shkurtër:** Ky lot përfshin sigurimin e pajisjeve dhe grupin e aktorëve që do të marrin pjesë në shfaqjen teatrale.
- **Objekti:** Ofrimi i një eksperience të veçantë kulturore dhe artistike për fëmijët pjesëmarrës.

LOTI 2: Realizimi dhe menaxhimi i aktivitetit shfaqje teatrale për të rritur

- **Përshkrimi i shkurtër:** Ky lot përfshin sigurimin e pajisjeve dhe grupin e aktorëve që do të marrin pjesë në shfaqjen teatrale.
- **Objekti:** Ofrimi i një eksperience të veçantë kulturore dhe artistike për të gjithë personat pjesëmarrës.

Shënim për aplikuesit: OJQ-të kanë të drejtë të aplikojnë për njërin lot ose për të dy lotet e përbashkëta, me kusht që të plotësojnë kriteret specifike teknike dhe të sigurisë për secilin lot veç e veç.

Kushtet e pjesëmarrjes

Të drejtë aplikimi në këtë thirrje publike kanë të gjithë organizatat joqeveritare (OJQ) që plotësojnë kushtet e mëposhtme:

1. Kriteret e Përgjithshme (Vejnë për të dyja lotet)

Aplikuesit duhet të dëshmojnë ligjshmërinë dhe rregullsinë e tyre operative përmes dokumenteve si vijon:

- **Regjistrimi ligjor:** Të jenë të regjistruar si person juridik në Republikën e Kosovës (Certifikata e Regjistrimit të Biznesit ose Certifikata e Regjistrimit të OJQ-së).
- **Statuti (për OJQ):** Statuti i shoqatës/klubit që dëshmon se fusha e veprimtarisë lidhet me artin dhe kulturën.
- **Rregullsia fiskale:** Vërtetimi nga Administrata Tatimore (ATK) që aplikuesi nuk ka obligime tatimore të papaguara (jo më i vjetër se 30 ditë nga data e aplikimit).

- **Llogaria bankare:** Konfirmimi i llogarisë bankare aktive në emër të biznesit apo OJQ-së.

2. Procedurat dhe kriteret e vlerësimit

Vlerësimi i aplikacioneve do të bëhet nga një komision profesional i emëruar nga institucioni, i cili do të kalojë nëpër dy faza:

FAZA I: Vlerësimi administrativ (Kriter eliminator)

Në këtë fazë, komisioni kontrollon nëse aplikuesi ka dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara tek "Kushtet e Pjesëmarrjes".

Mungesa e qoftë edhe një dokumenti të vetëm administrativ apo teknik sjell s'kualifikim automatik.

FAZA II: Vlerësimi me pikë (maksimumi 100 Pikë)

Aplikacionet që kalojnë fazën e parë do të vlerësohen në bazë të 4 kategorive kryesore:

Nr.	Kriteri i vlerësimit	Pikët maksimale
1	Kapaciteti profesional dhe përvoja (stafi) • Përvoja specifike në aktivitete të ngjashme kulturore/artistike (35 pikë). • Kualifikimi dhe certifikimet e aktorëve (35 pikë).	70 pikë
2	Kualiteti i propozimit dhe plani operativ • Metodologjia e realizimit të aktivitetit gjatë ditëve të shfaqjeve teatrale në kuadër të Kamenica Summerfest 2026. • Kapaciteti i pritjes së vizitorëve (sa persona mund të marrin pjesë në këtë aktivitet).	30 pikë

Pragu minimal për financim.

- Për t'u marrë në konsideratë për subvencionim, aplikacioni duhet të mbledhë të **paktën 60 pikë** në Fazën II.
- Fitues shpallet operatori që ka grumbulluar **numrin më të madh të pikëve**.

Shënim për transparencë: Komisioni do të hartojë një listë preliminare të pikëve, ndaj së cilës aplikuesit kanë të drejtë ankese brenda 5 (pesë) ditë pune nga data e publikimit të rezultateve.

Kamenicë, më 20.07.2026

Drejtori i DKRS



Afrim Dërvshi